



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P 199/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.05.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve standarde të tenderit për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me Nr. REF- 89791-03-11-2021, me objekt “*Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë*”, me fond limit 5,088,800 lekë pa TVSH, publikuar më datë 12.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

Ankimues: “Shaga” SHPK
Adresa: Rruga “Hamdi Pepa” ish parku industrial, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë
Adresa: Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu Medresesë, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave*

*Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së
Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë
gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.03.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me Nr. REF- 89791-03-11-2021, me objekt “*Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë*”, me fond limit 5,088,800 lekë pa TVSH, publikuar më datë 12.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

II.2. Në datën 18.03.2021, operatori ekonomik “*Shaga*” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentet si më poshtë:

Në faqen e Agjensisë së Prokurimit Publik, në datën 12.03.2021, është publikuar Procedura Konkurruese me Objekt: “Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë”, me Autoritet Kontraktor “Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë”, me Fond Limit 5,088,800 (pesë milion e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) Lekë pa TVSH, e cila ka datën e zhvillimit të saj dt.23.03.2021.

Në Shtojcën 8, të Dokumenteve Standarde të kësaj Procedure Konkurruese, Kriteret e Përgjithshme dhe kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Pika 2.3 Kapaciteti Teknik, si kriter i veçante për këtë procedurë konkurruese kërkohet

2.3 Kapaciteti teknik

2.3 Kapaciteti teknik:

Për sa i përket aftësisë teknike dhe profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të vendosura nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

a. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese autorizim prodhuesi ose distributor i autorizuar i mallrave objekt prokurimi të përshkruara në Shtojcën Nr.9 per produktet nga 1 ne 3, kjo e vertetuar nepermjet dokumenteve origjinalë (ose të njehsuar me origjinalin).Ne rast paraqitje autorizimi nga distributori zyrtar operatori ekonomik duhet të paraqesë akt marreveshje (origjinale ose e njehsuar me origjinalin), midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme, midis tyre. Autorizimi duhet të permbaje të dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme per autoritetin kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

b. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të posedojë në pronësi të vet ose me qira të paktën 2 (dy) mjete transporti ATP i cili do të përdoren për shpërndarjen dhe montimin e mallrave Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

c. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve te mallrave objekt prokurimi të përshkruara në Shtojcën Nr.9 Specifikimet Teknike, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen. Produktet nga 1 ne 3.

Në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, shprehet si më poshtë: Neni 20 (Mosdiskriminimi)

Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

Sqarojmë Autoritetin Kontraktor, që marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet kompanive që bashkëpunojnë në shumë fusha të veprimtarive tregtare, jo domosdoshmërisht lidhen me një kontratë, por bëhen nëpërmjet urdhër porosive, nëpërmjet Autorizimeve të lëshuara nga Kompania Prodhuese dhe që dërgohen me komunikime me email. Fakti që kriteri me lart është vendosur në këtë procedurë, si asnjëherë me parë për tu patur si reference, ngre dyshime shumë të mëdha për komprometimin e kësaj procedure, dhe parapërcaktimin e

fituesit të saj, duke shkelur kështu Nenin 20 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, të ndryshuar. Jo domosdoshmërisht marrëdhëniet ndërmjet kompanive prodhuese dhe distributor ndërtohen mbi bazë marrëveshjeje të shkruara formalisht, por mbi bazë komunikimesh me email, lista çmimesh të dërguara me email apo postë dhe shoqërohen me autorizimin e prodhuesit për produktet me të cilat furnizon distributorin.

Gjithashtu, është e paprecedentë më parë kërkesa që ka vendosur KVO në piken b) si më lart. Nuk bën sens, që të kërkohej të dorëzohen automjete ATP, ku nuk përcaktohet as një tonazh për këto automjete, as një përcaktim tjetër të qartë. Nëse vendoset vetëm ATP, atëherë do të thotë që çdo Operator Ekonomik pjesëmarrës mund të paraqesë edhe automjetet tip veturash të vogla 4+1, që sipas Lejes së Qarkullimit të tyre janë ATP, pasi transportojnë edhe produkte në përmasa të vogla. Duam tu vëmë në dukje KVO-së që ka hartuar kriteret për këtë procedurë, si mund të transportohen tavolinat apo dollapët me një automjet që transporton apo shpërndan pije freskuese në volum? Atëherë ky kriter ka nevojë që të qartësohet, dhe të vendoset çfarë lloj automjeti kërkohej me diapazon tonazhi të përcaktuar. Vetëm kështu mund të identifikohet kapaciteti i kompanisë pjesëmarrëse që do të konkurrojë në këtë procedurë.

Ngremë gjithashtu pyetjen, përse KVO në një procedurë me Objekt: "Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë", vë theksin vetëm në tre artikuj të kondicionimit, kur % me të madhe dhe volumin apo vendin më të madh në sasinë e mallit.. që prokurohet e zënë mobilet, si tavolina, dollapë etj. A mos vallë këto produkte nuk kanë rëndësi për këtë procedurë? A mos vallë KVO, po mundohet të paracakttojë fituesin e kësaj procedure duke ju kushtuar rëndësi kriterëve të tilla??

Në shtojcën 8, të Dokumenteve Standarde të kësaj Procedure Konkurruese, Kriteret e Përgjithshme dhe kriteret e Veçanta të Kualifikimit në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Pika 2.4 Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore dhe kapacitetin profesional të operatorit ekonomik, si kriter i veçantë për këtë procedurë konkurruese kërkohej:

2.4 Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore dhe kapacitetin profesional të operatorit ekonomik:

a) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për periudhën Nëntor 2020 - Janar 2021 të vërtetuar me listëpagesa të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe të shoqëruara me vërtetim nga Tatimet për numrin e punonjësve.

b) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre staf të kualifikuar dhe specialistët e domosdoshëm për të realizuar objektin e këtij prokurimi të cilët duhet të figurojnë në Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për periudhën Nëntor 2020-Janar 2021, minimumi;

- *1(një) ing. Mekanik (të paraqiten kontrata e punës dhe diploma)*
- *Minimumi 1 (një) specialist termoteknik sipas kodit të punës*
- *Minimumi 1 (një) specialist hidraulik sipas kodit të punës*
- *Minimumi 1 (një) specialist elektrikist sipas kodit të punës*

- *1 (një) specialist saldator me dëshmi kualifikimi nga organizëm i akredituar në Shqipëri.*
- *1 (një) punonjës, në zbatim të ligjit Nr.10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, që të jetë i pajisur me certifikatë trajnimi për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit të punonjësve. Për këtë të paraqitet certifikata e trajnimit nga një organizëm akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.*

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se nuk është prodhues i mobilieve të drurit, duhet të paraqesë një deklaratë ku të përcaktohet kompania prodhuese e mobilieve dhe vendi i origjinës.

d) Në rast se operatori ekonomik deklaron se vetëm do ti tregtojë produktet e mobilimit, duhet të ketë një staf punonjësish mesatarisht prej 7 (shtatë) personash për periudhën Nëntor 2020 – Janar 2021. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij të paktën 1 (një) arkitekt i cili duhet të jetë i pasqyruar në listë pagesat e mësipërme. Kjo kërkesë duhet të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së:

Diplomë, në degën përkatëse (origjinale ose kopje të noterizuar). Kontratë të vlefshme pune, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit te të gjitha produkteve objekt prokurimi.

e) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë Profesionale për pikën:

NS – 12 (A) Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

Objekti i kësaj procedure konkurruese është “Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë”, dhe nga specifikimet teknike të artikujve që do të prodhohen apo tregtohen/furnizohen, sipas Dokumenteve Standarde të kësaj Procedure Konkurruese, të gjitha artikujt e kërkuar të prodhohen, janë prej materiali mobilie druri apo derivate të tij apo kondicionerët që janë produkt që do të importohet dhe nuk prodhohet në fabrikat vendase, dhe në asnjë moment nuk del e nevojshme që subjekti të jetë i pajisur me Licenca Ndërtimi apo Certifikata që kanë të bëjnë me kompanitë e Ndërtimit si dhe stafin e kualifikuar për ndërtim, 1(një) ing.Mekanik (të paraqiten kontrata e punës dhe diploma), Minimumi 1(një) specialist termoteknik sipas kodit të punës, Minimumi 1(një) specialist hidraulik sipas kodit të punës, Minimumi 1(një) specialist elektrikist sipas kodit të punës.

Në këtë rast nuk jemi në një procedurë “PUNE” ku të kërkohen kapacitetet e kompanisë në gërmime, makineri, instalime, ndërtime por në një procedurë “MALLRASH” ku kërkohen të dorëzohen mobilie apo produkte të caktuara, dhe nevojiten kapacitete të një kompanie mobilimi prodhuese apo importuese/tregtuese, dhe kurrsesi ndërtuese.

KVO është e paqartë në kriteret që ka vendosur, të cilat bien edhe në kundërshtim me njëra tjetrën si p.sh:

Në pikën 2.4, paragrafi a) thuhet si më poshtë:

a) Operatori ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për periudhën Nëntor 2020 - Janar 2021 të vërtetuar me listëpagesa të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe e shoqëruara me vërtetim nga Tatimet për numrin e punonjësve.

Pra sipas kësaj pike OE duhet të ketë punësuar 10 punonjës.

Ndërsa në pikën 2.4, paragrafi d. shprehet si më poshtë:

d) Në rast se operatori ekonomik deklaron se vetëm do ti tregojë produktet e mobilimit, duhet të ketë një staf punonjësish mesatarisht prej 7 (shtatë) personash për periudhën Nëntor 2020 – Janar 2021. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij të paktën 1 (një) arkitekt i cili duhet të jetë i pasqyruar në listë pagesat e mësipërme. Kjo kërkesë duhet të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së:

Diplomë, në degën përkatëse (originale ose kopje të noterizuar). Kontratë të vlefshme pune, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ndërsa në këtë pikë shprehet që OE konkurrues duhet të ketë 7 punonjës.

A është e qartë KVO se çfarë po kërkon në këtë rast? Ku po vendos kriteret që bien në kundërshtim po me kriteret e vendosura me lartë, e aq me tepër në paragrafë brenda të njëjtës pikë.

KVO, duhet të qartësojë nëse OE duhet të ketë 7 apo 10 punonjës të deklaruar në listëpagesat e tyre.

Nuk ka sens, dhe është në shkelje të çdo akti ligjor kriteri i vendosur nga ana juaj për të dorëzuar dokumentacionin për të vërtetuar që disponojmë:

b) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre staf të kualifikuar dhe specialistët e domosdoshëm për të realizuar objektin e këtij prokurimi të cilët duhet të figurojnë në Listëpagesat e deklaruar në organet tatimore për periudhën Nëntor 2020-Janar 2021, minimumi;

- *1(një) ing. Mekanik (të paraqiten kontrata e punës dhe diploma)*
- *Minimumi 1 (një) specialist termoteknik sipas kodit të punës*
- *Minimumi 1 (një) specialist hidraulik sipas kodit të punës*
- *Minimumi 1 (një) specialist elektrikist sipas kodit të punës*

e) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë Profesionale për pikën

NS- 12 (A) Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

Këto janë Licenca, pajisje, personel i kualifikuar për procese të ndryshme ndërtimi apo elektrike por të cilat nuk kanë asnjë lidhje me objektin që prokurohet, pasi nuk personifikojnë as “prodhimin e mobilieve” as tregtimin e tyre, as tregtimin e pajisjeve të kondicionimit aq më tepër të vërtetojnë cilësinë e mallit të ofruar, pasi këto licenca dhe ky staf punonjësish i kërkuar kanë të bëjnë me procesin e ndërtimit, furnizimin e ashensorëve, instalimeve elektrike, instalime hidraulike, instalimeve termike, apo inxhinieri mekanik, çfarë makinerish do montohen? Çfarë makinerish do riparohen? Dhe jo me prodhimin apo furnizimin e mobilieve apo pajisjeve të kondicionimit të cilat në këtë rast sipas specifikimeve teknike kërkojnë të prodhohen në dru, derivate të druri (dru melamin apo MDF postfoarming), si edhe të tregtohen duke u marrë produkte të gatshme importi e më gjerë, apo materiale të tjera por që nuk janë armatura, instalime elektrike e beton. Kompanitë konkurruese jo domosdoshmërisht do të prodhojnë kondicionerët por do të tregtojnë ato dhe për këtë arsye nuk kanë pse nevojitet as specialist hidraulik, as specialist termik, as ai elektrik e aq më tepër Inxhinieri Mekanik. Kjo për faktin se te gjitha proceset e instalimeve të ndryshme, janë mbyllur paraprakisht nga kompanitë ndërtuese apo rikonstruktues, dhe kurrsesi nuk mund të kërkojnë të realizohen nga kompani furnizuese, tregtuese. Në rastin e kësaj procedure, produktet që duhet të instalohen, janë produkte të gatshme, që vetëm mund të montohen, në vendet e paracaktuara dhe instalimet e paracaktuara nga ana e kontraksionit ndërtimor që është realizuar paraprakisht në këtë godinë ku kërkojnë të vendosen kondicionerët dhe mobiliet.

Këto kritere janë në shkelje të neneve 20, 23 etj. të Ligjit Nr. 9643, dt. 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore në fuqi .

Pyetja tjetër që shtrojmë, është “Çfarë nënkupton KVO me termat “sipas kodit të punës”

Ne mbi 15 vite eksperiencë në fushën e prokurimeve publike, nuk e kemi hasur askund një kriter të tillë.. “sipas kodit të punës”... Çfarë nënkupton të thotë KVO me këtë kriter? Ku referohet? A mos ndoshta është ndonjë parashikim i Ligjit të ri për Prokurimet Publike? Por, sjellim në vëmendje që Ligj të Ri nuk ka hyrë ende në fuqi, dhe efektet e tij fillojnë nga dt. 31.03.2021.

Gjithsesi kërkojmë që KVO të na shpjegojë çfarë ka kërkuar të shprehë nëpërmjet këtij kriteri? Si mund të përmbushet ai?

Gjithashtu theksojmë se bazuar në legjislacionin në fuqi është detyrim ligjor për autoritetin kontraktor që harton specifikimet teknike që:

- Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

Për më tepër, duhet të theksojmë faktin se AK ka përdorur për këtë procedurë “Mallrash” Dokumentet Standarde të Punës. Kjo është një shkelje apo neglizhencë e rëndë e kryer nga KVO plotësues i dokumentacionit ligjor të kërkuar.

Operatori ekonomik konkurrues mund të jetë subjekt prodhues apo dhe subjekt tregtar për artikujt e kërkuar në këtë procedurë konkurrues, mund të ketë stafin e kualifikuar për prodhimin e mobilieve si Arkitekt, Inxhinier të Përpunimit të Drurit, Makineri të përpunimit të drurit dhe skeleteve metalike të mobilieve, makineri specifike të transportimit të mobilieve, licenca dhe standarde kombëtare dhe ndërkombëtare që i atribuohen një prodhuesi apo tregtari të mobilieve apo pajisjeve plotësuese të tyre për kompletimin e procesit të një arredimi si dhe duke përfshirë edhe produktet e kondicionimit që mund të tregtohen dhe shërbejnë për kompletimin e një arredimi.

Perderisa ky subjekt është i certifikuar me të gjitha standardet ISO për cilësinë, për mbrojtjen e mjedisit për sigurinë e punonjësve në punë, për integrimin e këtyre tre normave të përmendura më lart dhe gjithashtu përderisa operatori ekonomik mund të zotërojë certifikata të ndryshme të marra nga institucione ndërkombëtare për cilësinë e produkteve që ai ofron, me një markë të veten të regjistruar, nuk bën sens dhe është në shkelje të çdo akti ligjor kërkesa e këtyre kritereve shtesë të vendosura nga AK për këtë procedurë konkurruese.

Ajo që vihet re gjithashtu në këtë procedurë është dhe fakti që KVO ka hartuar kritere me dy standarde kërkesash. Ku për një subjekt që ofron pajisje kondicionimi kërkon të paraqitet jo vetëm autorizim prodhuesi apo distributori por edhe “kontratë/marrëveshje e këtij të fundit me prodhuesin”, dhe nuk ka vendosur asnjë kriter për tu plotësuar nga ana e kompanive konkurruese për të vërtetuar origjinën e mallit për produktet e mobilieve, duke vendosur si kriter një:

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se nuk është prodhues i mobilieve të drurit, duhet të paraqesë një deklaratë ku të përcaktohet kompania prodhuese e mobilieve dhe vendi i origjinës.

Si mund të vërtetohet cilësia, garancia, plotësimi apo përmbushja me korrektësi e kësaj kontrate me një “deklaratë të konkurruesit për prodhuesin e produkteve të mobilieve që oferton” ?

DEKLARATE???

A nuk është kjo një diskriminim i OE pjesëmarrëse në këtë procedurë, duke lehtësuar në maksimum dhe hequr të gjitha kriteret për vërtetimin e cilësisë së produktit të mobilieve të cilat zënë edhe peshën më të madhe, apo volumin më të madh të zërave në preventivin e kësaj procedure konkurruese, duke parafavorizuar një subjekt konkurrues sipas disa kritereve specifike që mund ti sigurojë apo disponon një OE specifik.

Ky trajtim jo në nivelin e duhur apo duke mos i përcaktuar rëndësi të njëjtë të gjitha produkteve që prokurohen në këtë procedure, ky hartim kritereesh i dystandardizuar, ngre të gjitha dyshimet që në këtë fazë KVO ka paracaktuar OE fitues.

Gjithashtu këtë trajtim diskriminues nuk e vëremë vetëm në hartimin e kriterëve, por edhe në hartimin e specifikimeve teknike të produkteve që kërkohen të dorëzohen.

Ku në shtojcën 9, Specifikimet Teknike, për artikujt e mëposhtëm janë kërkuar specifikimet si:

1. Pompë nxehtësie (chiller)

Pompë nxehtësie ajër/ujë me kompresor inverter.

<i>Kapaciteti i ftohjes:</i>	<i>11.2-12.2 kw</i>
<i>Fuqia përthithëse ne ftohje</i>	<i>2.88 kw</i>
<i>EER</i>	<i>4.0</i>
<i>Kapaciteti i ngrohjes:</i>	<i>12 -13 kw</i>
<i>Fuqia përthithëse ne ngrohje</i>	<i>2.95 kw</i>
<i>COP</i>	<i>4.2</i>
<i>Eficienta energjitike</i>	<i>A+/A++</i>
<i>Fuqia e pompës qarkulluese</i>	<i>87 Wat</i>
<i>Prurja e ujit</i>	<i>2.13 m³/ore</i>
<i>Volumi minimal I ujit</i>	<i>35 litra</i>
<i>Numri ventilatoreve</i>	<i>2</i>

2. Kondicioner 12000 btu

Kapaciteti i ftohjes:

- 3,2 (0,6~3,6) kw*
- 10,9 (2,0~12,2) BTU*

Energjia qe perthith *0,9 (0,1~1,4) kw*

Rryma qe perthith *4.5 A*

S.E.E.R. *6,1 A++*

Kapaciteti i ngrohjes :

- 3,4 (0,6~4,4) kw*
- 11,5 (2,0~15,0) BTU*

Energjia qe perthith *0,9 (0,1~1,5) kw*

Rryma qe perthith *4,4 A*

S.C.O.P.mesatar *4,0 A+*

S.C.O.P. në ngrohje *5,1 - A+++*

Kompresor: *rrotullues*

Furnizimi me energji elektrike: *V~,Ph,Hz 230, 1, 50*

Fluksi i ajrit: *550/430/300 m³/h*

Presion i zhurmës:

• *i brendshëm:* 42/37/35/28 dB(A)

• *i jashtëm:* 52 dB(A)

Temperatura e jashtme te punes: -15/+43°C

Lloji i gazit dhe sasia: R32 /g 650

Gjatesia e tubacioneve 20 m

Disniveli midis njesive 10 m

Lidhjet e gazit 3/8 9.35 inch

Lidhjet hidraulike 1/4 6.35 inch

3. Kondicioner 22000 btu

Kapaciteti i ftohjes:

• 6,1 (1,8~6,4) kw

• 20,9 (6,1~21,8) BTU

Energjia qe perthith 1,7 (0,4~2,2) kw

Rryma qe perthith 7,7 A

S.E.E.R. 6,1 A++

Kapaciteti i ngrohjes:

• 6,4 (1,6~6,6) kw

• 5,5 (1,3~5,6) frig/h x1000

• 21,9 (5,4~22,5) BTU

Energjia që përthith 1,8 (0,4~2,4) kw

Rryma që përthith 8,1 A

S.C.O.P. mesatar 4,0 A+

S.C.O.P. në ngrohje 5,1 - A+++

Kompresor: rrotullues

Furnizimi me energji elektrike: V~,Ph,Hz 230, 1, 50

Fluksi i ajrit: 550/610/250 m³/h

Presion i zhurmës:

• *i brendshëm:* 48/44/40/34 dB(A)

• *i jashtëm:* 57 dB(A)

Temperatura e jashtme te punes: -15/+43°C

Lloji i gazit dhe sasia: R32 /g 1300

Gjatesia e tubacioneve 25 m

Disniveli midis njesive 10 m

Lidhjet e gazit 5/8 15,9 inch
Lidhjet hidraulike 1/4 6.35 inch

Në një vështrim të thjeshtë të këtyre specifikimeve kaq strikte, të parapërgatitura dhe duke paracaktuar produktin, pa respektuar nenet 20, 23, 46 etj. dhe për më tepër në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, dt. 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe Nenin 27,30 etj. të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), Vendimet e mëparshme të KPP-së në lidhje me specifikimet teknike të produkteve, të cilat duhet të kenë të vendosur një "diapazon" e vetmja gjë që ka mbetur është të shkruhet edhe "Marka" e produktit për të thënë edhe fituesin e kësaj procedure.

Specifikimet teknike të produkteve më lartë, janë hartuar duke paracaktuar një produkt konkret që do të dorëzohet, pa krijuar asnjë hapësirë siç përcakton Ligji për të ofertuar produktet që përmban tregu dhe që përmbushin në mënyrën më të mirë të mundshme realizimin e qëllimit për të cilin po kërkohen. Ky paracaktim nga ana KVO-së diskriminon edhe ofertat më të mira të produkteve shumë herë më cilësore sesa janë shkruar në specifikim.

Të analizojmë produktet një nga një,

1. Pompë nxehtësie (Chiller)

Pompë nxehtësie ajër/ujë me kompresor inverter.

Kapaciteti i ftohjes: 11.2-12.2 kw

Fuqia përthithëse në ftohje 2.88 kw

Si mund të vendoset një fuqi fikse përthithëse, kur e saktë do ishte 2.80-3.00 kw apo 2.80-2.90 kë,

EER 4.0 ??... Mund të jetë 3.5-4, mund të jetë 4-5... por asnjëherë kaq fikse e përcaktuar...

Kapaciteti ngrohës: 12-13 kw

Fuqia përthithëse në ngrohje 2.95 kw mund të ishte 2.90 - 3.00

COP 4.2

Eficienta energjitike A+/A++

Fuqia pompës qarkulluese 87 Wat ?? mund të jetë 85-90 Wat... por jo 87 Wat siç e ka vendosur KVO

Prurja e ujit 2.13m³/orë mund të ishte 2- 2.2 apo 2-2.5 por jo kaq precize

Volumi minimal i ujit 35 litra

Numri ventilatorëve 2

Të gjitha specifikimet teknike të këtij produkti janë të paracaktuara pa diapazon. Kjo do të thotë që produkti është marrë gjendje diku, dhe janë prokuruar karakteristikat e atij produkti,

I njejtë arsyetim është edhe për specifikimet e produkteve me poshte,

2. Kondicioner 12000 btu

Kapaciteti i ftohjes:

3,2 (0,6-3,6) kw	Sa?
10.9(2,0-12,2) BTU	Sa?
Energjia që përthith	0,9 (0,1-1,4) kw sa do të jetë??
Ryma që përthith	4.5A
S.E.E.R	6.1 A++
Kapaciteti ngrohjes	
3,4 (0,6-4,4) kw	çfarë kërkon të shpjegojë KVO për këtë specifikim?
11,5 (2,0-15,0) BTU	po për këtë çfarë kërkon të shpjegojë KVO?
Energjia që përthith	0,9 (0,1-1,5) Kë po për këtë???
Ryma që përthith	4.4 A
S.C.O.P mesatar	4.4 A+
S.C.O.P me ngrohje	5,1 – A+++ kjo pa diapazon
Kompresor:	rrotullues
Furnizimi me energji elektrike:	V- Ph, Hz 230, 1, 50
Fluksi ajrit:	550/430/ 300 m ³ /h
Presioni zhurmës:	
i brendshëm:	42/37/35/28 dB (A)
i jashtëm:	52 dB (A)
Temperatura e jashtme të punës:	-15/+43 C
Lloji gazit dhe sasia: R32/g 650	për çfarë e përcakton llojin e gazit dhe sasinë, ne mund të paraqesim një produkt shumë herë më të mirë
Gjatësia Tubacioneve	20 m
Disniveli midis njësisve	10 m
Lidhjet e gazit	3/8 9.35 inch
Lidhjet hidraulike	1/4 6.35 inch

3. Kondicioner 22000 btu

Kapaciteti i ftohjes:

6,1 (1,8-6,4) kw çfarë kërkon të shpjegojë KVO për këtë specifikim?

20.9 (6,1-21,8) BTU po për këtë çfarë kërkon të shpjegojë KVO?

Energjia që përthith 1,7 (0,4-2,2) Kë,, po për këtë? 1.7 ??? a nuk është paracaktim, pavarësisht se çfarë përcakton (0,4-2,2), vendosja e pikës në fillim e komprometon çdo diapazon që ka vendosur KVO në kllapa.

Ryma që përthith 7.7 A një detajim kaq specifik është në shkelje të Nenit 23, të LPP, të cilin kemi cituar edhe më lart

S.E.E.R 6.1 A++

<i>Kapaciteti ngrohjes</i>	
6,4 (1,6-6,6) kw	
5,5 (1,3-5,6) frig/h x 1000	
21.9 (5,4- 22,5) BTU	
<i>Energjia që përthith</i>	1,8 (0,4-2,4) kw
<i>Ryma që përthith</i>	8.1 A
<i>S.C.O.P mesatar</i>	4.0 A+
<i>S.C.O.P me ngrohje</i>	5,1 – A+++
<i>Kompresor:</i>	<i>rrotullues</i>
<i>Furnizimi me energji elektrike:</i>	V- Ph, Hz 230, 1, 50
<i>Fluksi ajrit:</i>	550/610/ 250 m ³ /h
<i>Presioni zhurmës:</i>	
<i>i brendshëm:</i>	48/44/40/34 dB (A)
<i>i jashtëm:</i>	57 dB (A)
<i>Temperatura e jashtme të punës:</i>	-15/+43 C
<i>Lloji gazit dhe sasia:</i>	R32/g 1300
<i>Gjatësia Tubacioneve</i>	25 m
<i>Disniveli midis njësive</i>	10 m
<i>Lidhjet e gazit</i>	5/8 15.9 inch
<i>Lidhjet hidraulike</i>	1/4 6.35 inch

Nëse do ti analizojmë çdo specifikim/detaj teknik të të tre produkteve më lartë që kemi cituar, jo vetëm atyre pikave që kemi komentuar, të gjitha janë vendosur në shkëlqje të LLP dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore për prokurimet publike si dhe Vendimeve të KPP për praktikë referuese.

Ne theksojmë se, KVO në hartimin e specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të Autoritetit Kontraktor duhet të ketë në vëmendje se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Theksojmë gjithashtu se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma “b” dhe “c” e LPP-së) janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomik, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës.

Specifikimet teknike duhet të jenë sa më gjithëpërfshirëse, por pa cenuar thelbin e garancisë mbi cilësinë e shërbimit/punës/mallit/ që autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë.

Për sa më lartë argumentuar,

Kriteret e vendosur nga ana juaj të cilat cituam me lart: (Pika 2.3, Kapaciteti teknik, a, b dhe c, Pika 2.4 a, b, c, d dhe e) si edhe gjithashtu shtojca 9, Specifikimet Teknike të hartuara për artikujt 1,2,3.

Janë kritere diskriminues për operatorët ekonomik pjesëmarrës, qofshin këto tregtarë, importues apo dhe prodhuese, pasi këto kritere janë vendosur në tejkallim të kufijve të lejuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, duke shkelur nenet 20, 23, 46 etj. dhe për më tepër në kundërshtim të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Nenin 27, 30 etj. të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), duke modifikuar procedurat dhe duke përdorur kritere të cilat janë diskriminuese që paracaktojnë fituesin e kësaj Procedure.

Kritere të tilla, të cilat nuk janë në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga ligji, janë diskriminues dhe cenojnë në thelb edhe realizimin e kësaj procedure konkurruese.

Kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, për kualifikimin e Operatorëve Ekonomik që do të marrin pjesë në një procedurë konkurruese, bazuar në Ligjin Nr. 9643, dt. 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar, duhet të jenë të lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe në asnjë moment nuk duhet të jenë diskriminuese. Kriteret që ne kemi kundërshtuar dhe për të cilat po kërkojmë të hiqen nga kërkesat për kualifikim në këtë procedurë konkurruese, janë të vendosura në kundërshtim të plotë me kufijtë e lejuar dhe të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, dhe për sa shpjeguem më lart, kërkojmë nga ana juaj ndryshimin e tyre.

Për sa më lart, kërkojmë nga ana juaj që të rishikohen Kriteret e vendosura në Dokumentet Standarde, në Shtojcën 8, duke hequr kriteret e vendosura në Pikën 2.3, Kapaciteti teknik, paragrafët a, b dhe c, Pika 2.4 a, b, c, d dhe e) si edhe gjithashtu shtojca 9, Specifikimet Teknike të hartuara për artikujt 1, 2, 3 dhe të kërkohen të paraqiten dokumente të cilat janë në përputhje me objektin e prokurimit dhe me legjislacionin në fuqi.

Përfundimisht, nisur nga sa argumentuam më lart.

- Kërkojmë nga ana juaj si Autoritet Kontraktor, rishikimin dhe ndryshimin e kushteve të vendosura në Shtojcën 8, të Dokumenteve Standarde të Procedurës Konkurruese me Objekt: “Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë”, si dhe specifikimet teknike në Shtojcën 9, për artikujt 1, 2 dhe 3.

- Ndryshimin e tyre duke marrë parasysh ankesën e paraqitur nga ana jonë.

II.2.1. Në datën 23.03.2021 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 972/4 i kthen përgjigje palës ankimuese “Shaga” SHPK duke vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe referimit me dokumentet standarde të tenderit po ju paraqesim vendimin e autoritetit kontraktor ne lidhje me ankesën tuaj si më poshtë vijon:

Kërkesa për heqjen/rishikimin e kriterit:

a) Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizim prodhuesi ose distributor i autorizuar i mallrave objekt prokurimi të përshkruara në Shtojcën Nr.9 per produktet nga 1 ne 3, kjo e vertetuar nepermjet dokumenteve origjinalë (ose të njehsuar me origjinalin).Ne rast paraqitje autorizimi nga distributori zyrtar operatori ekonomik duhet te paraqesë akt marreveshje (origjinale ose e njehsuar me origjinalin), midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme, midis tyre. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme per autoritetin kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

KSHA sqaron sa vijon: Ky kriter ka për qëllim që t'i sigurojë AK: realisht dhe besueshmërisht se shpenzimet që po ata po kryejnë janë të garantuara për origjinën dhe cilësinë e mallrave që do të blihen. Ky kriter i shërben AK për të vërtetuar aftësinë teknike të/operatorëve ekonomikë që paraqesin oferta dhe bazuar ne Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” ndryshuar.

Njësia e Prokurimit ka kërkuar Autorizim prodhuesi ose distributor i autorizuar për 3 artikuj nga 64 artikuj që kërkohen të blihen gjithsej dhe mendojmë që ka marrë në konsideratë Rekomandimin e APP nr. 6732 Prot. datë 21.10.2020 ku ndër të tjera shprehet:

Autoritetet Kontraktor në dokumentet e tenderit për mallra apo edhe në rastin e punëve publike, kërkojnë që operatorët ekonomikë të paraqesin përveç autorizimit të prodhuesit, katalogëve, skedave teknike apo raporteve të testimiit edhe certifikata të ndryshme ISO që prodhuesi (i cili nuk ka lidhje me procesin) duhet të disponojë veçanërisht certifikatë të menaxhimit të cilësisë së prodhuesit të mallit.

KSHA VENDOSI: Kërkesa për heqjen e këtij kriteri nuk pranohet.

Kërkesa për heqjen/rishikimin e kriterit:

b) Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të posedojë në pronësi të vet ose me qira të paktën 2 (dy) mjete transporti ATP i cili do të përdoren për shpërndarjen dhe montimin e mallrave Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

KSHA VENDOSI: Kërkesa për sqarimin e këtij kriteri pranohet dhe do të formulohet si vijon: Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti mallrash, me kapacitet transportues të paktën 1 ton me qëllim transportin e mallit, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

a) Dokument që vërteton pronësinë ose qiramarrjen si më poshtë:

- *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*
 - *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*
- *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*
 - *Kontratë qiraje.*
 - a) *Leje qarkullimi e mjetit.*
 - b) *Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,*
 - c) *Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,*
 - d) *Certifikate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg).*

KSHA VENDOSI: Kërkesa për heqjen e këtij kriteri nuk pranohet.

Kërkesa për heqjen/rishikimin e kriterit:

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të mallrave objekt prokurimi të përshkruara në Shtojcën Nr.9 Specifikimet Teknike, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen. Produktet nga 1 në 3.

KSHA VENDOSI: Pranimin e kërkesës së Ankimuesit për rishikim të kriterit dhe do të riformulohet: Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/broshurë për artikujt 1.2.3 dhe 4 të shtojcës nr. 9. ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre (specifikimet teknike të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë/broshura duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt 1. 2. 3 dhe 4 dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 9 të DST.

Kërkesa e ankimuesit për rishikimin dhe ndryshimin e specifikimeve teknike në shtojcën nr. 9. për artikujt 1. 2 dhe 3 do të pranohet dhe do të ndryshohet si më poshtë:

1. Pompë nxehtësie (chiller)

Pompë nxehtësie ajër/ujë me kompresor inverter.

Kapaciteti i ftohjes: Brenda kufijve 11-12.5 kw

Fuqia perthithese ne ftohje ≤ 3 kw

EER: ≥ 4.0

Kapaciteti i ngrohjes: Brenda kufijve 12 -13,5 kw

Fuqia perthithese ne ngrohje ≤ 3 kw

COP: ≥ 4.2

Eficienta energjitike: A+/A++
Fuqia e pompes qarkulluese ≤ 90 wat
Prurja e ujit Brenda kufijve 2-2.2 m3/orë
Volumi minimal I ujit: Brenda kufijve 32- 37 litra
Numri ventilatoreve Jo më shumë se 2
Garancia duhet të jetë minimumi 1(një) vit nga data e marrjes në dorëzim.

2. Kondicioner 9.000 btu

Tensioni: 220-230 V; 50 Hz
Fuqia në (BTU): 9.000 BTU
Teknologjia inverter: Po
Niveli i zhurmes (dBa): ≤ 45 dBa (i brendshëm)
Klasi i energjisë: A++/A+
Lloji i gazit: R410A/R32
Kapaciteti i ngrohjes: ≥ 10.500 BTU
Kapaciteti ftohës: ≥ 9.000 BTU
Temperatura e jashtme te punës: -15/+43°C
Telekomanda: Po
Ngjyra: E bardhë

3. Kondicioner 12000 btu

Tensioni: 220-230 V
Fuqia në (BTU): 12.000 BTU
Teknologjia inverter: Po
Niveli i zhurmes (dBa): ≤ 45 dBa (i brendshëm)
Klasi i energjisë: A++/A+
Lloji i gazit: R410A/R32
Kapaciteti i ngrohjes: ≥12.000 BTU
Kapaciteti ftohës: ≥ 11.800 BTU
Temperatura e jashtme te punës: -15/+43°C
Telekomanda: Po
Ngjyra: E bardhë

4. Kondicioner 22.000 btu

Energjia elektrike: 220-230 V; 50 Hz
Fuqia në (BTU): 22.000 BTU
Teknologjia inverter: Po

Niveli i zhurmës (dBa): ≤ 50 dBa (i brendshëm)

Klasi i energjisë : A++

Lloji i gazit: R410A/R32

Kapaciteti i ngrohjes: ≥ 22.000 BTU

Kapaciteti ftohës: ≥ 21.600 BTU

Temperatura e jashtme të punës: $-15/+43^{\circ}\text{C}$

Telekomanda: Po

Ngjyra: E bardhë

Garancia e kondicionerëve duhet të jetë minimumi 1 (një) vit nga data e marrjes në dorëzim.

Për sa i përket kërkesës së ankimesi për të hequr licencën:

NS - 12 (A) Impiante teknologjik termikë dhe të kondicionimit.

Kërkesa e Autoriteti Kontraktor është minimale dhe aspak diskriminuese.

*Në formularin e ofertës përfshihen mallrat e domosdoshëm që shërbejnë për instalimin e chillerit ngrohje-ftohje, fan-coila, tub dërgim/kthim për ujë të ngrohtë 1 ¼” tub dërgim/kthim për ujë të ngrohtë 1, Armafleks 13 * 42 – 1”, Armafleks 13 * 42 -1 ¼, rakorderi çeliku, tub shkarkimi + rakorderi me ngjitje 32 mm me gominë, prizhionera, fasheta, kapse për tubin, tub kondicioneri i termoizoluar o 6, tub kondicioneri i termoizoluar o 12. Auto mat magneto-termik 380 V, 40 A, 4P Id = 0.03 A. Kabull elektrik 5 x 2.5. Tub spiral ½”. Nastro alumini, fije komande për chillerin grup rimbushës automatik ½”, manometer uji ½”, filter uji përpara chillerit 1”, saraçineska me hollandez tek chilleri 1 ¼, kolektor shpërndarës 1 ¼, buketona kolektori, çajrues ½, tape bronxi, Ti bronxi, termostat mural për fan-coil (elektronike), guano elektrike, kabull elektrik për komandimin e termostateve etj.”.*

Këto instalime të këtyre produkteve të sistemit ngrohje-ftohje mund dhe duhet të realizohen nga një kompani detyrimisht e licencuar për këto sisteme, specialistët e kërkuar nga ana e AK në DST të paktën nën drejtimin e një inxhinieri mekanik pa të cilin dhe me eksperiencë pune të paktën 5 vjet operatori ekonomik nuk mund të pajiset me Licencë Profesionale NS-12 (A) Impiante teknologjike termike dhe të kondicionimit

(nuk është përfshirë ose kërkuar inxhinier elektrik me qëllimin për të rritur pjesëmarrjen).

Por për t'u bërë e qartë se ofertuesi e ka për detyrë edhe montimin e mallit është vendosur në pikën 2.4, d paragraf i fundit: Deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit montimit të të gjitha produkteve objekt prokurimi.

Mendojmë që të mos ndryshohet por të bëhet shpjegimi shërbimeve në lidhje me furnizimin e mallit.

Për sa i përket ankesës për shprehjen: Sipas kodit të punës... të kërkuar për specialistët riformulohet si vijon

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre staf të kualifikuar dhe specialistët e domosdoshëm për të realizuar objektin e këtij prokurimi të cilët duhet të figurojnë në Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për periudhën Nëntor 2020- Janar 2021, minimumi;

- *1(një) ing. Mekanik (të paraqiten kontrata e punës dhe diploma)*
- *Minimumi 1 (një) specialist termoteknik me dëshmi kualifikimi nga organizëm i akredituar në Shqipëri si edhe me kod pune në listepagesë minimumi 3 muajt e fundit*
- *Minimumi 1 (një) specialist hidraulik me dëshmi kualifikimi nga organizëm i akredituar në Shqipëri si edhe me kod pune në listepagesë minimumi 3 muajt e fundit*
- *Minimumi 1 (një) specialist elektrikist me dëshmi kualifikimi nga organizëm i akredituar në Shqipëri si edhe me kod pune në listepagesë minimumi 3 muajt e fundit*

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mallrat do të lëvrohen të shoqëruara me garancitë përkatëse (të përcaktuara në DST dhe në kontrate) në marrëveshjen e përcaktimit të kushteve të garancisë, para lidhjes së kontratës do të definohen dhe mënyrat, koha, dhe çdo specifikim tjetër i vlefshëm dhe i detyrueshëm për palët kontraktuese.

Të gjitha mallrat të cilat do të lëvrohen nga operatori ekonomik fitues duhet të jenë patjetër konform ofertës teknike të ofruar dhe të depozituar duke përfshirë cilësitë teknike dhe markën e prodhuesit.

Për sa i përket punës që do të kryhet në ambientet ku do të instalohen kondicionerët, chillerat dhe fan-coil do të jetë e nevojshme të hapen vrima në mure dhe prishen pjesë muri ose dyshemeje për shkak instalimeve të reja që do të kryhen. Eshtë e nevojshme të behen instalime të reja elektrike dhe mekanike nga vendi i instalimit të chillerave e deri të ushqimi elektrik. Pas instalimit të kondicionerëve, chillerave dhe fan-coil , do të mbyllen vrimat apo pjesët e murit të dëmtuara me material përkatës të njëjtë me ekzistuesin. Pasi të përfundojë instalimi do të bëhet një testim i për funksionimin e tyre. Të gjitha këto shërbime do të merren përsipër nga operatori ekonomik dhe do të mbyllen me shpenzimet e tij. Për sa sqarohet më lart theksojmë se:

Në formularin i ofertës përfshihen mallrat e domosdoshëm që shërbejnë për montimin si:

-tub dergimi/kthimi për uje te ngrohte 1 1/4 ", tub dergimi/kthimi për uje te ngrohte 1", Armafleks 13 x 42 - 1", Armafleks 13 x 42 - 1"1/4, rakorderi çeliku, tub shkarkimi + rakorderi me ngjitje 32 mm me gomine, prizhionera, fasheta, kapese për tubin, tub kondicioneri I termoizoluar Ø 6, tub kondicioneri I termoizoluar Ø 12, Automat magnetotermik 380V, 40A, 4P, Id=0.03A, Kabëll elektrik 5 x 2,5, Tub spiral 1/2 ", Nastro alumini, fije komande për chillerin, grup rimbushes, automatik 1/2 ", manometer uji 1/2 ", filter uji përpara chillerit 1", saracineska me hollandeze tek chilleri 1 1/4", kolektor shpërndaresh 1 1/4", buketona kolektori, çajrues 1/2", tape bronxi, Ti bronxi, termostatat mural për fan-coil (elektronike), guaino elektrike, kabell elektrik për komandimin e termostateve etj.-.

Gjithashtu KSHA vendosi që të riformatohet Formulari i Ofertës si vijon:

<i>Nr</i>	<i>Përshkrimi i mallrave</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi njësi</i>	<i>Çmimi total</i>	<i>Afati</i>
<i>A</i>	<i>Blerje dhe montim moblieri</i>					<i>30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës</i>
<i>1</i>	<i>Stol metalik me 3 karrike për pritje në holli</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>			
<i>2</i>	<i>Karrige - Poltronë për vend pune drejtuesi</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>			
<i>3</i>	<i>Karrige-Poltronë për vend pune specialisti</i>	<i>copë</i>	<i>6</i>			<i>“ “ “</i>
<i>4</i>	<i>Karrige për tavolinë mbledhjeje</i>	<i>copë</i>	<i>10</i>			<i>“ “ “</i>
<i>5</i>	<i>Karrige per femije</i>	<i>copë</i>	<i>10</i>			<i>“ “ “</i>
<i>6</i>	<i>Karrige e thjeshtë per ngrënie</i>	<i>copë</i>	<i>8</i>			<i>“ “ “</i>
<i>7</i>	<i>Karrige e thjeshtë</i>	<i>copë</i>	<i>8</i>			<i>“ “ “</i>
<i>8</i>	<i>Krevat terapie</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>			<i>“ “ “</i>
<i>9</i>	<i>Tavolinë pune specialisti 1</i>	<i>copë</i>	<i>5</i>			<i>“ “ “</i>
<i>10</i>	<i>Tavolinë pune me kënd:</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>			<i>“ “ “</i>
<i>11</i>	<i>Tavolinë pune drejtuesi:</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>			<i>“ “ “</i>
<i>12</i>	<i>Tavolinë mbledhjeje për 12 vende</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>			<i>“ “ “</i>
<i>13</i>	<i>Tavolinë leximi për 6 vende</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>			<i>“ “ “</i>
<i>14</i>	<i>Tavolinë ngrënieje për 6 persona</i>	<i>copë</i>	<i>4</i>			<i>“ “ “</i>
<i>15</i>	<i>Tavolinë e vogël mesi per femije</i>	<i>copë</i>	<i>4</i>			<i>“ “ “</i>
<i>16</i>	<i>Tavolinë e vogël mesi</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>			<i>“ “ “</i>
<i>17</i>	<i>Komodine per kuzhinen (mbajtje+shperndarje ushqimi) 60x60 cm me sirtarë</i>	<i>copë</i>	<i>3</i>			<i>“ “ “</i>
<i>18</i>	<i>Komodina me 3 sirtare</i>	<i>copë</i>	<i>6</i>			<i>“ “ “</i>
<i>19</i>	<i>Mobilie kuzhine me lavapjatë</i>	<i>ml</i>	<i>1</i>			<i>“ “ “</i>
<i>20</i>	<i>Rafte Element gjysem i</i>	<i>copë</i>	<i>8</i>			<i>“ “ “</i>

	<i>hapur</i>					
21	<i>Raft i hapur metalik</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>			“ “ “
22	<i>Etazher i vecante per tv dhe salle mbledhjesh</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>			“ “ “
23	<i>V Reception një post + tavoline:</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>			“ “ “
24	<i>Varëse Rrobash "prift" :</i>	<i>copë</i>	<i>5</i>			“ “ “
25	<i>Tabelë shkrimi e bardhe vendosur ne mur:</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>			“ “ “
	Çmimi neto A					
Janar 2021 të vërtetuar me listëpagesa të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe të shoqëruara me vërtetim nga Tatimet për numrin e punonjësve. **b)** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre staf të kualifikuar dhe specialistët e domosdoshëm për të realizuar objektin e këtij prokurimi të cilët duhet të figurojnë në Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për periudhën Nëntor 2020- Janar 2021, minimumi; 1(një) ing. Mekanik (të paraqiten kontrata e punës dhe diploma); Minimumi 1 (një) specialist termoteknik sipas kodit të punës; Minimumi 1 (një) specialist hidraulik sipas kodit të punës; Minimumi 1 (një) specialist elektrikist sipas kodit të punës; 1 (një) specialist saldator me dëshmi kualifikimi nga organizëm i akredituar në Shqipëri; 1 (një) punonjës, në zbatim të ligjit Nr.10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, që të jetë i pajisur me certifikatë trajnimi për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit të punonjësve. Për këtë të paraqitet certifikata e trajnimit nga një organizëm akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. **c)** Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se nuk është prodhues i mobilieve të drurit, duhet të paraqesë një deklaratë ku të përcaktohet kompania prodhuese e mobilieve dhe vendi i origjinës. **d)** Në rast se operatori ekonomik deklaron se vetëm do ti tregojë produktet e mobilimit, duhet të ketë një staf punonjësish mesatarisht prej 7 (shtatë) personash për periudhën Nëntor 2020 – Janar 2021. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij të paktën 1 (një) arkitekt i cili duhet të jetë i pasqyruar në listë pagesat e mësipërme. Kjo kërkesë duhet të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së: Diplomë, në degën përkatëse (origjinale ose kopje të noterizuar). Kontratë të vlefshme pune, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Objekti i kësaj procedure konkurruese është “Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë”, dhe nga specifikimet teknike të artikujve që do të prodhohen apo tregtohen/furnizohen, sipas Dokumenteve Standarde të kësaj Procedure Konkurruese, të gjitha artikujt e kërkuar të prodhohen, janë prej materiali mobilie druri apo derivate të tij apo kondicionerët që janë produkt që do të importohet dhe nuk prodhohet në fabrikat vendase, dhe në asnjë moment nuk del e nevojshme që subjekti të jetë i pajisur me Licenca Ndërtimi apo Certifikata që kanë të bëjnë me kompanitë e Ndërtimit si dhe stafin e kualifikuar për ndërtim, 1(një) ing.Mekanik (të paraqiten kontrata e punës dhe diploma), Minimumi 1(një) specialist termoteknik sipas kodit të punës, Minimumi 1(një) specialist hidraulik sipas kodit të punës, Minimumi 1(një) specialist elektrikist sipas kodit të punës. Në këtë rast nuk jemi në një procedurë “PUNE” ku të kërkohen kapacitetet e kompanisë në gërmime, makineri, instalime, ndërtime por në një procedurë “MALLRASH” ku kërkohen të dorëzohen mobilie apo produkte të caktuara, dhe nevojiten kapacitete të një kompanie mobilimi prodhuese apo importuese/tregtuese, dhe kurrsesi ndërtuese. KVO është e paqartë në kriteret që ka vendosur, të cilat bien edhe në kundërshtim me njëra tjetrën si p.sh: Në pikën 2.4, paragrafi a) thuhet si më poshtë: a) Operatori ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për periudhën Nëntor 2020 - Janar 2021 të vërtetuar me listëpagesa të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe të shoqëruara me vërtetim nga Tatimet për numrin e punonjësve. Pra sipas kësaj pike OE duhet të ketë punësuar 10 punonjës. Ndërsa në pikën 2.4, paragrafi d. shprehet si më poshtë: d) Në rast se operatori ekonomik deklaron se vetëm do ti tregojë produktet e mobilimit, duhet të ketë një staf punonjësish mesatarisht prej 7 (shtatë) personash për periudhën Nëntor 2020 – Janar 2021. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij të paktën 1 (një) arkitekt i

cili duhet të jetë i pasqyruar në listë pagesat e mësipërme. Kjo kërkesë duhet të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së: Diplomë, në degën përkatëse (origjinale ose kopje të noterizuar). Kontratë të vlefshme pune, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ndërsa në këtë pikë shprehet që OE konkurrues duhet të ketë 7 punonjës. A është e qartë KVO se çfarë po kërkon në këtë rast? Ku po vendos kritere që bien në kundërshtim po me kriteret e vendosura me larte, e aq me tepër në paragrafë brenda të njëjtës pikë. KVO, duhet të qartësojë nëse OE duhet të ketë 7 apo 10 punonjës të deklaruar në listëpagesat e tyre. Nuk bën sens, dhe është në shkelje të çdo akti ligjor kriteri i vendosur nga ana juaj për të dorëzuar dokumentacionin për të vërtetuar që disponojmë: b) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre staf të kualifikuar dhe specialistët e domosdoshëm për të realizuar objektin e këtij prokurimi të cilët duhet të figurojnë në Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për periudhën Nëntor 2020- Janar 2021, minimumi; 1 (një) ing. Mekanik (të paraqiten kontrata e punës dhe diploma); Minimumi 1 (një) specialist termoteknik sipas kodit të punës; Minimumi 1 (një) specialist hidraulik sipas kodit të punës; Minimumi 1 (një) specialist elektrikist sipas kodit të punës”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.4.”Kapaciteti teknik” nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar si më poshtë:

- a) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për periudhën Nëntor 2020 - Janar 2021 të vërtetuar me listëpagesa të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe të shoqëruara me vërtetim nga Tatimet për numrin e punonjësve.
- b) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre staf të kualifikuar dhe specialistët e domosdoshëm për të realizuar objektin e këtij prokurimi të cilët duhet të figurojnë në Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për periudhën Nëntor 2020- Janar 2021, minimumi;
 - 1 (një) ing. Mekanik (të paraqiten kontrata e punës dhe diploma)
 - Minimumi 1 (një) specialist termoteknik sipas kodit të punës
 - Minimumi 1 (një) specialist hidraulik sipas kodit të punës
 - Minimumi 1 (një) specialist elektrikist sipas kodit të punës
 - 1 (një) specialist saldator me dëshmi kualifikimi nga organizëm i akredituar në Shqipëri.
 - 1 (një) punonjës, në zbatim të ligjit Nr.10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, që të jetë i pajisur me certifikatë trajnimi për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit të punonjësve. Për këtë të paraqitet certifikata e trajnimit nga një organizëm i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

- c) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se nuk është prodhues i mobilieve të drurit, duhet të paraqesë një deklaratë ku të përcaktohet kompania prodhuese e mobilieve dhe vendi i origjinës.*
- d) *Në rast se operatori ekonomik deklaron se vetëm do të tregtojë produktet e mobilimit, duhet të ketë një staf punonjësish mesatarisht prej 7 (shtatë) personash për periudhën Nëntor 2020 – Janar 2021. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij të paktën 1 (një) arkitekt i cili duhet të jetë i pasqyruar në listëpagesat e mësipërme. Kjo kërkesë duhet të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së:*

Diplomë, në degën përkatëse (origjinale ose kopje të noterizuar). Kontratë të vlefshme pune, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- e) *Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë Profesionale për pikën:*

NS – 12 (A) Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

III.2.2. Në dokumentet e tenderit të modifikuara shtojca 8/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.4.”Kapaciteti teknik” nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar si më poshtë:

ISHTE:

2.4 Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore dhe kapacitetin profesional të operatorit ekonomik:

- f) *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 10 (dhjete) punonjës për periudhën Nëntor 2020 - Janar 2021 të vërtetuar me listëpagesa të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe të shoqëruara me vërtetim nga Tatimet për numrin e punonjësve.*
- g) *Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre staf të kualifikuar dhe specialistët e domosdoshëm për të realizuar objektin e këtij prokurimi të cilët duhet të figurojnë në Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për periudhën Nëntor 2020- Janar 2021, minimumi;*
- *1(një) ing. Mekanik (të paraqiten kontrata e punës dhe diploma)*
 - *Minimumi 1 (një) specialist termoteknik sipas kodit të punës*
 - *Minimumi 1 (një) specialist hidraulik sipas kodit të punës*
 - *Minimumi 1 (një) specialist elektrikist sipas kodit të punës*
 - *1 (një) specialist saldator me dëshmi kualifikimi nga organizem i akredituar në Shqipëri.*
 - *1 (një) punonjës, në zbatim të ligjit Nr.10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, që të jete i pajisur me certifikate trajnimi për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit të punonjësve. Për këtë të paraqitet certifikata e trajnimit nga një organizmi akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e*

Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

- h) Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se nuk është prodhues i mobilieve të drurit, duhet të paraqesë një deklaratë ku të përcaktohet kompania prodhuese e mobilieve dhe vendi i origjinës.*
- i) Në rast se operatori ekonomik deklaron se vetëm do të tregtojë produktet e mobilimit, duhet të ketë një staf punonjësish mesatarisht prej 7 (shtatë) personash për periudhën Nëntor 2020 – Janar 2021. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij të paktën 1 (një) arkitekt i cili duhet të jete i pasqyruar në liste pagesat e mësipërme. Kjo kërkesë duhet të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së:*

Diplomë, në degën përkatëse (origjinale ose kopje të noterizuar). Kontratë të vlefshme pune, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit të të gjitha produkteve objekt prokurimi.

- j) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë Profesionale për pikën:*

NS – 12 (A) Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

BËHET:

2.4 Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore dhe kapacitetin profesional të operatorit ekonomik:

- a) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për periudhën Nëntor 2020 - Janar 2021 të vërtetuar me listëpagesa të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe të shoqëruara me vërtetim nga Tatimet për numrin e punonjësve.*
- b) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre staf të kualifikuar dhe specialistët e domosdoshëm për të realizuar objektin e këtij prokurimi të cilët duhet të figurojnë në Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për periudhën Nëntor 2020- Janar 2021, minimumi;*
 - 1 (një) ing. Mekanik (të paraqiten kontrata e punës dhe diploma)*
 - Minimumi 1 (një) specialist termoteknik me deshmi kualifikimi nga organizem i akredituar në Shqipëri si edhe në listëpagese minimumi 3 muajt e fundit*
 - Minimumi 1 (një) specialist hidraulik me deshmi kualifikimi nga organizem i akredituar në Shqipëri si edhe në listëpagese minimumi 3 muajt e fundit*
 - Minimumi 1 (një) specialist elektrikist me deshmi kualifikimi nga organizem i akredituar në Shqipëri si edhe në listëpagese minimumi 3 muajt e fundit*
 - 1 (një) specialist saldator me deshmi kualifikimi nga organizem i akredituar në Shqipëri.*

- 1 (një) punonjës, në zbatim të ligjit Nr.10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, që te jete i pajisur me certifikate trajnimi për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit të punonjesve. Për këtë të paraqitet certifikata e trajnimit nga një organizemi akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se nuk është prodhues i mobilieve të drurit, duhet të paraqesë një deklaratë ku të përcaktohet kompania prodhuese e mobilieve dhe vendi i origjinës. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij të paktën 1 (një) arkitekt i cili duhet të jete i pasqyruar në liste pagesat e mësipërme. Kjo kërkesë duhet të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së: Diplomë, në degën përkatëse (origjinale ose kopje të noterizuar). Kontratë të vlefshme pune, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.2.3. Në nenin 27, pikat 3 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, parashikohet se:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.4. Në nenin 20 “Mosdiskriminimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

“Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e

asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: *(i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese*, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në këtë kontekst, Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme dhe e domosdoshme që të sigurohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, disponojnë kapacitetet teknike për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në rastin konkret, referuar objektit dhe volumit të kontratës objekt prokurimi, Komisioni konstaton se, kërkesa e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë numrit të punonjësve dhe profileve të tyre lë shteg për diskriminim dhe trajtim të pabarabartë të ofertuesve të mundshëm, pasi nuk janë në përputhje me përcaktimet e nenit 46 të ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, ku në mënyrë eksplicite autoriteteve kontraktore ju njihet e drejta për të kërkuar dokumentacion vërtetues, me qëllim që të sigurohen mbi kapacitetet të operatorëve ekonomik pjesëmarrës, për përmbushjen me sukses të kontratës, por gjithmonë këto kërkesa duhet të jenë në përputhje me parashikimet ligjore të LPP. Në rastin konkret referuar formularit të ofertës si dhe shtojcës së specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi se ofertuesi disponon staf të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Por referuar kriterit për vërtetimin e disponimit të kapacitetit të ofertuesit për 10 (dhjetë) punonjës të parashikuar në pikën 2.4/a Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor ka tejkaluar natyrën dhe përmasat e kontratës, pasi një numër i tillë punonjësish është joproportional me objektin e prokurimit. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme të provohet disponimi i punonjësve por kjo duhet të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme duke pasur parasysh elementë të tillë si natyra e kontratës dhe volumi i saj. Komisioni vlerëson se kriteri i sipërcituar nuk është hartuar tërësisht në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, pasi ka kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Në këtë kuptim Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa më sipër duke përcaktuar një numër të arsyeshëm dhe proporcional me përmasat e kontratës që do të prokurohet me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1, pika 2, të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit*

publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës, duke evituar kushte kufizuese sikundër në rastin konkret, pasi një kriter i tillë nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës, por krijon efektin e kufizimit për pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Për autoritetin kontraktor e rëndësishme të provohet disponimi i punonjësve, por kjo duhet të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme duke pasur parasysh elementë të tillë si natyra e kontratës dhe volumi i saj. Komisioni vlerëson se, kriteri i sipërcituar nuk është hartuar tërësisht në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, pasi ka kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke përfshirë në të vetëm ata operatorë të cilët plotësojnë numrin e kërkuar prej 10 (dhjetë), si dhe duke përjashtuar kështu operatorë të tjerë ekonomikë të cilët edhe pse mund të garantojnë zbatimin e kontratës, si dhe mund të përmbushin të gjitha kriteret kualifikuese për këtë procedurë prokurimi, do të penalizohen vetëm për faktin se nuk përmbushin numrin e kërkuar të punonjësve, duke marrë parasysh që në kontratën objektë prokurimi volum më të madhë zënë zërat furnizim në krahasim me zërat që janë furnizim-vendosje, pra një kërkesë për një numër të tillë punonjësish është i ekzagjeruar. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të unifikojë kërkesat për sa i përket numrit të punonjësve, në mënyrë që të krijohet panoramë e qartë mbi furnizimet që do të kryhen, si dhe të mos krijohet konfuzion tek operatorët ekonomikë të interesuar për të hartuar ofertat e tyre teknike dhe ekonomike. Vlen të theksohet, se dokumentet e tenderit, nga autoriteti kontraktor, duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë. Numri i punonjësve i përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit është i ekzagjeruar joproporcional me objektin e prokurimit, dhe ndikon në uljen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si dhe bie ndesh me frymën e ligjit, i cili parashikon se kriteret për kualifikimin duhet të hartohen në atë mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël. Për autoritetin është e rëndësishme të vërtetohet se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike (në rastin konkret punonjës), mjaftueshëm, sa të jetë në gjendje të realizojë objektin e prokurimit. Komisioni Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri duke ulur numrin e punonjësve dhe duke përcaktuar në mënyrë të saktë një numër minimal të arsyeshëm dhe proporcional me volumin dhe përmasat e objektit të prokurimit, të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, duke nxitur pjesëmarrjen e ofruesve në procedurën e prokurimit, siç parashikohet në nenin 1 të LPP-së.

Rrjedhimisht, sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2.8. Në interpretim literal të bazës ligjore të sipërcituar Komisioni vlerëson se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, por duhet në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, që mund të shfaqin interes për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor në vendosjen e këtij kriteri është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë stafin me profilet e duhura e duhura për realizimin me sukses të kontratës në përputhje me kohëzgjatjen e parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe njëherazi në përputhje me cilësinë e kërkuar. Referuar natyrës së kontratës e cila është një kontratë furnizim malli dhe instalim i disa zërave të parashikuar në preventiv, KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për *“një inxhinier Mekanik dhe një specialist hidraulik”* nuk është në proporcion dhe në përputhje me objektin e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që në objektin në të cili do të kryhet furnizim i mallrave është parashikuar edhe instalimi i disa prej zërave të preventivit si chiller apo kondicioner, është mëse e mjaftueshme disponimi i specialistëve si termoteknik dhe elektrikist, ndërkohë kërkesa e autoritetit kontraktor edhe për disponueshmëri të një ing mekanik dhe një specialisti hidraulik është një kërkesë e ekzagjeruar, e pajustificuar dhe jo në propocion dhe në përputhje me objektin e prokurimit. KPP gjykon se operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se gëzojnë kapacitetet e duhura profesionale për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për *“një inxhinier Mekanik dhe një specialist hidraulik”* është diskriminuese dhe nuk i shërben hapjes së konkurrencën për sa kohë që nuk lidhet as me natyrën e kontratës që autoriteti kërkon të prokurojë. KPP konstaton se kriteri i mësipërm nuk është në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, ndaj duke marrë parasysh natyrën e kontratës, zërat në preventiv, gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për një *“një inxhinier Mekanik dhe dhe një specialist hidraulik”* është një kërkesë kufizuese e ekzagjeruar e pajustificuar dhe aspak në përputhje me volumin e kontratës objekt prokurimi dhe nuk i shërben qëllimit të kontratës së prokurimit. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet ta heqë kërkesën e mësipërme. Por vlen të theksohet, se në dokumentet e tenderit, nga autoriteti kontraktor, duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë dokumentacioni që duhet të paraqesin operatorët ekonomik mbi disponueshmërinë e specialistëve në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

Rrjedhimisht, sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Shaga” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...] Keni kërkuar kategorinë e licencës NS-12 (A), ndërkohë që kjo kategori është vetëm për punime ndërtimore apo elektrike por të cilat nuk kanë asnjë lidhje me objektin që prokurohet. Këto janë Licenca, pajisje, personel i kualifikuar për procese të ndryshme ndërtimi apo elektrike por të cilat nuk kanë asnjë lidhje me objektin që prokurohet, pasi nuk personifikojnë as “prodhimin e mobilieve” as tregtimin e tyre, as tregtimin e pajisjeve të kondicionimit aq më tepër të vërtetojnë cilësinë e mallit të ofruar, pasi këto licenca dhe ky staf punonjësish i kërkuar kanë të bëjnë me procesin e ndërtimit, furnizimin e ashensorëve, instalimeve elektrike, instalime hidraulike, instalimeve termike, apo inxhinieri mekanik, çfarë makinerish do montohen? Çfarë makinerish do riparohen? Dhe jo me prodhimin apo furnizimin e mobilieve apo pajisjeve të kondicionimit të cilat në këtë rast sipas specifikimeve teknike kërkohen të prodhohen në dru, derivate të druri (dru melamin apo MDF postfoarming), si edhe të tregtohen duke u marrë produkte të gatshme importi e më gjerë, apo materiale të tjera por që nuk janë armatura, instalime elektrike e beton. Kompanitë konkurruese jo domosdoshmërisht do të prodhojnë kondicionerët por do të tregtojnë ato dhe për këtë arsye nuk kanë pse nevojitet as specialist hidraulik, as specialist termik, as ai elektrik e aq më tepër Inxhinieri Mekanik. Kjo për faktin se të gjitha proceset e instalimeve të ndryshme, janë mbyllur paraprakisht nga kompanitë ndërtuese apo rikonstruktues, dhe kurrsesi nuk mund të kërkohen të realizohen nga kompani furnizuese, tregtuese. Në rastin e kësaj procedure, produktet që duhet të instalohen, janë produkte të gatshme, që vetëm mund të montohen, në vendet e paracaktuara dhe instalimet e paracaktuara nga ana e kontruksionit ndërtimor që është realizuar paraprakisht në këtë godinë ku kërkohen të vendosen kondicionerët dhe mobilet. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën nr. 8/2, pika 2.4/e “Për kapacitetin teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë Profesionale për pikën:

NS – 12 (A) Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

III.3.2. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor “Shtojcë për ndryshime të dokumenteve standarde të tenderit me objekt “Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë”, është hequr kriteri si më poshtë:

Në Dokumentet Standarde të Tenderit tek shtojca 8/2, Kapaciteti teknik , pika 2.4/e:

Ishte:

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë Profesionale për pikën:

Bëhet:

Pika 2.4/e kapacitetit teknik Hiqet nga kriteret.

III.2.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, duke qenë se pretendimi i operatorit ekonomik “Shaga” SHPK është pranuar nga autoriteti kontraktor, dhe në shtojcën e publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike është hequr si kriter, ky pretendim i ngritur nga operatori ekonomik ankimues nuk do të merret në shqyrtim në themel, pasi nuk ekziston më si objekt ankimi.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Shaga” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...] Ajo që vihet re gjithashtu në këtë procedurë është dhe fakti që KVO ka hartuar kriteret me dy standarde kërkesash. Ku për një subjekt që ofron pajisje kondicionimi kërkon të paraqitet jo vetëm autorizim prodhuesi apo distributori por edhe “kontratë / marrëveshje e këtij të fundit me prodhuesin”, dhe nuk ka vendosur asnjë kriter për tu plotësuar nga ana e kompanive konkurruese për të vërtetuar origjinën e mallit për produktet e mobilieve, duke vendosur si kriter një: c) “Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se nuk është prodhues i mobilieve të drurit, duhet të paraqesë një deklaratë ku të përcaktohet kompania prodhuese e mobilieve dhe vendi i origjinës”. Si mund të vërtetohet cilësia, garancia, plotësimi apo përmbushja me korrektësi e kësaj kontrate me një “deklaratë të konkurruesit për prodhuesin e produkteve të mobilieve që oferton” ? DEKLARATE???. A nuk është kjo një diskriminim i OE pjesëmarrëse në këtë procedurë, duke lehtësuar në maksimum dhe hequr të gjitha kriteret për vërtetimin e cilësisë së produktit të mobilieve të cilat zënë edhe peshën më të madhe, apo volumin më të madh të zërave në preventivin e kësaj procedure konkurruese, duke parafavorizuar një subjekt konkurrues sipas disa kriterëve specifikë që mund ti sigurojë apo disponon një OE specifik. Ky trajtim jo në nivelin e duhur apo duke mos i përcaktuar rëndësi të njëjtë të gjitha produkteve që prokurohen në këtë procedure, ky hartim kriteresh i distandardizuar, ngre të gjitha dyshimet që në këtë fazë KVO ka paracaktuar OE fitues.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8/2 pika 2.4.c “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se nuk është prodhues i mobilieve të drurit, duhet të paraqesë një deklaratë ku të përcaktohet kompania prodhuese e mobilieve dhe vendi i origjinës”.

III.3.2. Në shtojcën 8/2 të modifikuar pika 2.4.c “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

BËHET:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, ne rast se nuk është prodhues i mobilieve te drurit, duhet te paraqese një deklaratë ku të përcaktohet kompania prodhuese e mobilieve dhe vendi i origjinës. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij të paktën 1 (një) arkitekt i cili duhet te jete i pasqyruar ne liste pagesat e mësipërme. Kjo kërkesë duhet të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së: Diplomë, në degën përkatëse (origjinale ose kopje të noterizuar). Kontratë të vlefshme pune, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1/b të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.3.4. Në nenin 57 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se: “Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:
- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;
- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);
- përllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;
- hartimin e urdhrat të prokurimit;
- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;
- hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;
- administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;
- llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti.”

Lidhur me pretendimin mbi kërkimin për sa i përket deklaratës që duhet të dorëzojnë operatorët ekonomik nëse nuk janë prodhues të mobilieve ku operatori ekonomik ngre pretendime se autoriteti kontraktor duhet të shtojë kërkesa në lidhje dokumentacionin që duhet të dorëzojnë operatorët kur nuk janë prodhues të mobilieve dhe të mos kufizohet vetëm tek një deklaratë, KPP gjykon se kjo në thelb ka të bëjë me shtim kriteri dhe jo me një pretendim për modifikimin e një kriteri kufizues, diskriminues, i cili do të shkaktonte skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e

prokurimeve publike (*neni 19/1 e vijues i LPP-së*) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (*neni 12 i LPP-së*) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 63 pika 1.1. të LPP-së, parashikohet se “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.*” KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (*legjitimimi pasiv*), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve, pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (*reale*) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurave për fitimin e kontratave publike, do ti nënshtrohet kushteve specifike (*kritereve të veçanta të kualifikimit*), të cilat duhet të përmbushin parakushtin të parashikuar nga neni 46 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, duke qenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Në rastin konkret, KPP gjykon se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriteret minimale kualifikuese, të gjykuar të nevojshme për vërtetimin e plotësisht të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (*dokumentet e procedurës së prokurimit*) duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, të ndryshuar dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 63 pika 4 gërma “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (*verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknik janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji*), por mbi shtimin e kriterëve kualifikuese në një procedurë prokurimi, pasi kërkimi i bërë nga ana e operatorit ekonomik ankimues në ankesë, konsiderohet kriter i ri që do të rëndonte pozitat e operatorëve ekonomik të interesuar. Sa më sipër, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (*vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara*) nuk

janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor është mjaftuar vetëm me një deklaratë nga ana e operatorëve ekonomikë nëse ata nuk janë prodhues të mobilieve duhet të paraqesin një deklaratë ku të përcaktojnë kompaninë prodhuese të mobilieve dhe vendin e origjinës, për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në mënyrë eksplicite kërkimin e dokumentacionit si autorizime prodhuesi apo autorizime nga distributori i prodhuesit për artikujt e mobilieve, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kritere të tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shaga” SHPK për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me Nr. REF- 89791-03-11-2021, me objekt “Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë”, me fond limit 5,088,800 lekë pa TVSH, publikuar më datë 12.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimues “Shaga” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 514 Protokoli, Datë 01.04.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri